

OLGER BRAME

RRETH FJALORIT TË HOMONIMEVE TË GJUHËS SHQIPE

Çështja që do të trajtohet në këtë kumtim ka një interes në rrethet e gjuhëtarëve, sidomos për teorinë dhe praktikën leksikografike të fjalorëve shpjegues, por edhe për fjalorët dygjuhësh, shqip-gjuhë e huaj, që sot janë të shumtë në numër.

Kumtesa jonë mëton të trajtojë dy probleme kryesore: cilat janë sot konceptet kryesore për homoniminë, si një dukuri në zhvillim e sipër dhe çfarë zgjidhjesh konkrete janë dhënë dhe jepen në leksikografinë shqiptare për homonimet.

1. Në gjuhësinë shqiptare, mund të thuhet me plot gojë, sot ka studime të plota lidhur me dukurinë e homonimisë¹, pra janë bërë përcaktimet e duhura për këtë term “fjalë me të njëjtën përbërje tingëllore, por me kuptime krejt të ndryshme” (te këto fjalë të shënuarit e ndryshëm janë pa lidhje midis tyre dhe lidhen secili veçmas me shënuesin), janë studiuar rrugët e lindjes së homonimeve në gjuhën shqipe, si: ndryshimi ose evolucioni fonetik i fjalëve (prej fjalësh me rrënjë të ndryshme, nëpërmjet evolucionit fonetik ka ndodhur përputhja e tyre me njëra-tjetrën. Kështu, *pjek_I* “vë diçka në furrë” ka dalë nga një rrënjë më e vjetër **pek*, ndërsa *pjek_{II}* “takoj” rrjedh prej rrënjës **plek*)², ndryshimi dhe shkëmbimi i fjalëve ndërmjet dialekteve dhe dialekteve me gjuhën letrare (*baj_I kal. “mbart”//baj_{II} kal. “”bëj” etj.*)³, përputhja fonetike e fjalëve me burime të ndryshme (ver/ë-a_I f.”stina e nxehtë e vitit...”(< lat.) // ver/ë-a_{II} “pije që del nga tharbëtimi i mushtit të rrushit (*ven),⁴ fjalëformimi (p.sh. *rendoj_I* dhe *rendoj_{II}* – nga emri *rend-i m.* formohet folja *rendoj_I kal.* “vë në rend, radhit, kurse nga emri *rendë-ja f.* formohet një folje tjetër *rendoj_{II} kal.* “grij me rende”)⁵, zberthimi apo shpërbërja e polisemisë (këto quhen homonime semantike, të cilat krijohen në ato raste kur kuptime që dikur përfaqësonin semema të së njëjtës fjalë, janë larguar nga njëri-tjetri, pasi është shuar tipari semantik që i mbante të bashkuara rreth kuptimit kryesor. Në këtë rast ndahen në fjalë të veçanta kuptimet e së njëjtës fjalë, p.sh. dy kuptimet e foljes kallëztoj, mund të trajtohen si homonime; *kallëzon_I jokal.v.III* “nxjerr kalli drithi” // *kallëzon_{II} kal. v.III.* “i bën të njohur dikujt një çështje që duhet të dijë; tregon, rrëfen”) etj.⁶

¹ Xh. Lloshi, *Vëzhgime mbi homonimet në gjuhën shqipe*, në “Studime mbi leksikun dhe formimin e fjalëve në gjuhën shqipe”, I, Tiranë, 1972, f. 203-227.

² J. Thomai, *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, 2006, f. 140.

³ Shih, po aty, f. 141.

⁴ Shih, po aty, f. 140-141.

⁵ Shih, po aty, f. 143.

⁶ Për më tepër shih: J. Thomai, *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, 2006, f. 141-143.

Lidhur me homoniminë, studiuesi Xhevat Lloshi thekson se: *Homonimia është një polisemi e rreme, domethënë kemi po atë kompleks tingullor, por jo me kuptime të ndryshme, sepse me të vërtetë janë leksema të ndryshme, që kanë përkuar fonetakisht. Në ligjërimin e zakonshëm ajo nuk bie në sy, madje janë gjuhëtarët që e tregojnë si dukuri, sepse në të kundërt, folësit nuk e njohin aspak.*⁷

Brenda klasës së homonimeve janë dalluar *homonimet leksikore* ose të *mirëfillta* (që kanë të njëjtën përmbajtje tingëllore, kanë kuptime leksikore krejt të ndryshme dhe i përkasin së njëjtës pjese të ligjëratës, si: *shapkë_I* “kasketë”, *shapkë_{II}* “pandofla”, *shapkë_{III}* “lloj shpendi, shaptore”), *homonimet leksikogrammatikore* (që kanë të njëjtën përbërje tingëllore, kanë kuptime leksikore krejt të ndryshme dhe nuk i përkasin së njëjtës pjese të ligjëratës: *vesh_I* “emër” dhe *vesh_{II}* “folje”), homonimet e pjesëve të ligjëratës (që kanë të njëjtën përbërje tingëllore, kanë kuptime leksikore të afërta dhe u përkasin pjesëve të ndryshme të ligjëratës: *ndryshk_I* “emër” dhe *ndryshk_{II}* “folje”). Më tej, ka një ndarje tjetër: *homonime të plota* (homonimet leksikore) dhe *homonime të pjesshme* (homofoma, homografe dhe homofone). I përmendëm shkurtimisht të ilustruara në disa raste edhe me shembuj këto ndarje, jo se nuk dihen, por për të dalë te çështja e dytë: *si janë trajtuar homonimet nga ana leksikografike në vepra të ndryshme.*

2. Studiuesi Xhevat Lloshi ka bërë një shqyrtim të plotë të kësaj çështjeje duke nisur nga fjalorë të ndryshëm të shqipes të botuar në shek. XIX dhe në gjysmën e parë të shek. XX, ndaj nuk po ndalemi këtu. Në vështrim janë marrë veprat e fundit të leksikografisë shqiptare, duke filluar nga *Fjalori i Gjuhës së Sotme Shqipe* (1980). Përfundimi i parë që mund të thuhet është se në këto vepra, homonimet e gjuhës shqipe pasqyrohen në mënyrën më të plotë. Studiuesi Jani Thomai, duke u mbështetur në këtë fjalor, thotë se në shqipe ka 500 çifte ose vargje homonimesh të tipave të ndryshëm me rreth 1050 njësi leksikore. Pasqyrimi i homonimeve në FGjSSh (1980) u mbështet në një bazë të qartë teorike për atë kohë. Studiuesi Androkli Kostallari te “Parimet themelore për hartimin e fjalorit të gjuhës së sotme shqipe”⁸, shkruan edhe disa çështje të trajtimit leksikografik të të homonimeve. Ai thekson se ato do të jepen si fjalë më vete, duke i shpallur sipas parimit semantiko-strukturor, parim i cili mbështetet në ndërtimin semantik të vetë fjalës, në vendin që zë fjala në strukturën e gjuhës së sotme, në tërësinë e veçorive strukturore të saj, pra: lidhjet e saj fjalëformuese, marrëdhëniet e saj me fjalët rrënjë etj.

Në *Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe* (1980) janë përfshirë tre grupe homonimesh:

a- homofomat, d.m.th. fjalët që përputhen nga pikëpamja tingullore në një ose disa forma, por ndryshojnë në trajta të tjera; si bazë për këtë në fjalor merret homonimia e trajtave përfaqësuese, p.sh.: *çaj-i_I* emër dhe *çaj_{II}* folje: çava, çarë, *çaj dru*, *çaj akullin*, *çaj dëborën* etj.; *ca_I* për. pacak. = *ca* njerëz, disa njerëz; dhe *ca_{II}*

⁷ Xh. Lloshi, *Stilistika dhe pragmatika*, Tiranë, 1999, f. 130.

⁸ A. Kostallari, *Parimet themelore për hartimin e “Fjalorit të gjuhës së sotme shqipe”*, në “Studime filologjike”, nr. 2, 1968.

ndajf. rri edhe ca, u bë ca më mirë, shko ca më tutje, ca nga ca etj.; *punëtor-i_I* emër dhe *punëtor-i_{II}* mb.; *thatë i, e_I* mbiemër dhe *thatë i, e_{II}* emër, sh. të *thatë-t* etj.

b- fjalët me prejardhje të ndryshme, që janë përputhur nga pikëpamja tingullore në të gjitha trajtat ose në shumicën e trajtave, p.sh.: *pjek_I, poqa, pjekur*: pjek bukë, pjek mishin në hell, pjek tulla etj. dhe *pjek_{II}, poqa, pjekur* “tako”; *çek-e_I* si emër “që ka lindur e banon në Çeki” dhe *çek-u_{II}* në veprimet bankare etj.;

c- homonimet semantike, d.m.th. fjalët me prejardhje të përbashkët, te të cilat këputja, thyerja e lidhjeve semantike midis kuptimeve, ndarja e boshtit themelor semantik shkon aq larg sa që shoqërohet edhe me vendosjen e veçorive të reja strukturore-gramatikore e fjalëformuese, p.sh.: *botë_I* “baltë e bardhë” dhe *botë_{II}* “rruzulli, toka, njerëzia, njerëzit”; *fletë-a_I* “gjethi”; *fletë-a_{II}* “krah, flatër”; *fletë-a_{III}* “një fije letër” etj.

Pavarësisht nga mbushullia homonimike, ky fjalor nuk mundi të jepte në mënyrën më të plotë dhe shteruese pasurinë homonimike të gjuhës shqipe. Më pas u botuan fjalorë të tjerë, sidomos fjalorë dialektorë etj., që nxorën në dritë shumë e shumë njësi të tjera homonimike.

Kësisoj lindi nevoja e hartimit të një fjalori të mirëfilltë homonimik të gjuhës shqipe, i cili do të zgjidhte edhe më mirë pasqyrimin leksikografik të homonimeve në gjuhën shqipe.

Përpjekja e parë dhe e vetme deri tani është ajo e profesorëve dhe studiuesve të gjuhës shqipe Bahtijar Kryeziu dhe Ali Jashari, me botimin modest të vitit 2008, në Prishtinë, “*Fjalor i homonimeve të gjuhës shqipe*”⁹, i cili kaloi pa u vënë re nga kritika gjuhësore shqiptare. Botimi i këtij fjalori, nga autorët Kryeziu dhe Jashari, nuk vjen nga një truall i zbrazët. Ndihtesat e të dy profesorëve do të dallohen ndër vite përmes studimeve e artikujve të botuar në revistat e periodikët tanë shkencorë, për t’u kurorëzuar më vonë në botime të veçanta teorike e praktike në Prishtinë, Korçë e më gjerë. Të gjitha studimet e artikujt shkencorë të profesorëve Bahtijar Kryeziu e Ali Jashari të botuara veçan, në periodikë shkencorë, a të paraqitura në konferenca, bashkë me punën e tyre të gjerë, të vëllimshme e cilësore edhe në fushën leksikografike, e dëshmojnë mirë këtë.

Hartimi i këtij fjalori homonimik, sipas autorëve, ishte një dëshirë e hershme e tyre, që të përmbledhnin dhe të shpjegonin homonimet e gjuhës shqipe, për dy arsye: e para për pasurinë e madhe homonimike që ka gjuha shqipe të pasqyruar në fjalorë të ndryshëm¹⁰, nga të cilët është marrë gjithë lënda; e dyta, sepse mjaft

⁹ B. Kryeziu & A. Jashari, *Fjalor i homonimeve të gjuhës shqipe*, Shkëndija, Prishtinë, 2008.

¹⁰ Shih po aty, *Bibliografia e veprave të vjela*: A. Zymberi, *Fjalor i fjalëve të rralla*, Prishtinë, 1979; *Leksiku bujqësor e blegtoral i të folmeve në Mal të Zi*, Prishtinë, 1996; A. Dhrimo, E. Tupja, E. Ymeri, *Fjalor sinonimik i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2002; A. Leotti, *Dizionario Albanese-Italiano*, Roma, 1937; D. N. Gazulli, *Fjalorth i ri*, Visaret e kombit, vëll. XI (fjalë të rralla të përdorura në Veri të Shqipnis, Tiranë, 1941; F. Cordignano, *Dizionario Italiano-Albanese*, Shkodër, 1938; F. Rossi *Vocabolario Epirotico-Italiano*, v. i, Roma, 1866; F. Reçani, *Të folmet shqipe të Pollogut*, Shkup, 2001; *Fjaluer i ri i shqyppes*, Bashkimi, Shkodër, 1908; *Fjalor i gjuhës së sotme*

koncepte e probleme për homoniminë ishin trajtuar e zgjidhur nga gjuhësia shqiptare dhe këto shërbyen për përzgjedhjen e materialit të vjelë¹¹.

Ky ka qenë korpusi bazë, zgjedhja e të cilit ka shërbyer si punë paraprake për ndërtimin e fjalorit nga autorët, punë e cila, siç dihet, lidhet edhe me një sërë problematikash që kanë të bëjnë me kritere e parime të përzgjedhjes, metodën e përdorur në përzgjedhjen e korpusit të fjalëve, vështirësitë që mund të shkaktojnë homonimet në kontekste të caktuara të ligjëritit etj. Fjalori pasqyron gjendjen aktuale të gjuhës, d.m.th. pasqyron nivelin e tanishëm të sistemit që është në zhvillim të vazhdueshëm.

Fjalori i homonimeve të gjuhës shqipe, i botuar nga “Shkëndija”, Prishtinë, në vitin 2008, është i pari i këtij lloji për shqipen, jo vetëm si një pasqyrë e plotë e homonimeve deri në atë kohë, por edhe për parimet dhe kriteret shkencore mbi të cilat është hartuar, duke shfrytëzuar arritjet më të mira të leksikografisë shqiptare në fushën e fjalorëve shpjegues, si dhe duke dhënë zgjidhje teorike dhe praktike edhe për një sërë çështjesh të tjera që lidhen me hartimin e fjalorëve të këtij lloji. Fjalori fillon me një parathënie nga vetë autorët, ku jepen sqarime të kuptueshme dhe të plota, për çdo përdorues të tij, lidhur me përkufizimin klasik të homonimeve, shkaqet dhe rrugët e lindjes së tyre, ndarja në grupe, rrugët për shmangien e homonimeve në gjuhë etj. Fjalori vazhdon me një listë të plotësuar shkurtësash (rreth 120 të tilla), e cila u vjen në ndihmë përdoruesve të tij gjatë punës me të, si dhe shenjat e vendosura në fjalor.

Duke shfrytëzuar fjalorë të ndryshëm të shqipes, autorët kanë trajtuar në këtë fjalor mbi 700 çifte e vargje homonimike të tipave të ndryshëm, që përfshijnë gati 1470 fjalë. Për çdo homonim të çiftit a vargut në fjalor, jepen ilustrime me më shumë se një shembull, çka e ndihmon përdoruesin për të kuptuar edhe kontekstin e përdorimit të fjalës homonime.

Natyrisht, që ky fjalor nuk është një fjalor shterues. Pas botimit të parë, autorët kanë vazhduar vjeljen e mëtejshme të njësive homonimike, duke arritur të

shqipe, Tiranë, 1980; *Fjalor i shqipes së sotme*, Tiranë, 1984; *Fjalor i shqipes së sotme*, Tiranë, 2002; J. Junku, *Fjaluar i voghel Scryp e Latinisct*, n’Scoder, 1895; J. Nushi, *Fjalë popullore nga Myzeqeja*, Tiranë, 1991; J. Thomai, M. Samara, H. Shehu, K. Cipo, E. Çabej, A. Krajinj, O. Myderrizi, *Fjalor i gjuhës shqipe*, Tiranë, 1954; K. Kristoforidhi, *Leksikon Alvano – Elenikon*, Athinë, 1904, transkriptuar me alfabet shqip e përpunuar prej Aleksandër Xhuvanit, 1961; M. Ahmetaj, *Fjalor i të folmeve të shqiptarëve në Mal të Zi*, Prishtinë, 1996; *E folmja e Plavës dhe Gucisë*, Prishtinë, 2002; P. Haxhillazi – S. Ahmeti, *Fjalor i shqipes së Plavës e Gucisë*, 2004; P. Tase, *Fjalorthi i ri*, Visaret e kombit, vëll.XII (fjalë të rralla të përdorura në Jug të Shqipnis), Tiranë, 1941; P. Zeneli, *Fjalor i fjalëve dhe shprehjeve të rralla*, Tiranë, 1999; P. Cullbashi, *Faqe nga visari leksikor i Mirditës*, Mirditë, 2002; Q. Murati, *Fjalor i fjalëve të rralla të përdorura në viset e Maqedonisë*, Shkup, 2003; Sh. M. Haxhihyseni, *Guri i rëndë në vend të vet*, Elbasan, 2004; S. Pepa, *Tradita bujqësore nëpërmjet thesarit gjuhësor*, vëll. II, Shkodër, 2002; Th. Feka, *Fjalor sinonimik i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2004; V. Memisha, *Emërtime për kafshë e shpendë në Labëri*, Gjirokastër, 2001.

¹¹ Shih për këtë sqarim të autorëve parathënien e fjalorit.

Rreth fjalorit të homonimeve të gjuhës shqipe

skedojnë rreth 3200 njësi të tilla¹², shumica e të cilave janë vargje homonimike, duke bërë njëkohësisht edhe plotësime sasiore dhe cilësore, për të pasqyruar gjithë korpusin e homonimeve në gjuhën shqipe.

Mendojmë se një botim i plotë i kësaj pasurie do të ishte një ndihmesë e vyer për gjuhësinë shqiptare, me vlera të rëndësishme për teorinë e leksikografisë dhe, njëkohësisht, si udhëzues i dobishëm për leksikografët, për punën e tyre në hartimin e fjalorëve të homonimeve e të fjalorëve të tjerë gjuhësorë, për shkollarët që mësojnë gjuhën shqipe e më gjerë.

BIBLIOGRAFI

- A. Jashari, *Për fjalën shqipe*, Recension, Prishtinë, 2013, f. 255-256.
- A. Kostallari, *Parimet themelore për hartimin e fjalorit të gjuhës së sotme shqipe*, në "Studime filologjike", nr. 2, 1968.
- B. Kryeziu & A. Jashari, *Fjalor i homonimeve të gjuhës shqipe*, "Shkëndija", Prishtinë, 2008.
- J. Thomai, *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, 2006, f. 140-143.
- Xh. Lloshi, *Vëzhgime mbi homonimet në gjuhën shqipe*, në Studime mbi leksikun dhe formimin e fjalëve në gjuhën shqipe, I, Tiranë, 1972, f. 203-227.
- Xh. Lloshi, *Vëzhgime mbi homonimet në gjuhën shqipe*, në Studime filologjike, nr. 2, 1964.
- Xh. Lloshi, *Stilistika dhe pragmatika*, Tiranë, 1999, f. 130.

¹² Sipas autorëve të fjalorit.

